POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Me këmbët e gjymtura dhe i bërë zi nga tymi, foto e 27-vjeçarit pak para se të vdiste, qytetarët e marrin prej krahu ta nisin në spital (FOTO)

2 Krim i rëndë në familje, babai vret me kallash të birin në Kosovë! Shkak, konflikti për pronën

3 'Vajza është gjallë, 2 burra e mbajnë pa dëshirën e saj', letra tronditëse por që jep shpresë për gjetjen e Artemisës, 19-vjeçaren shqiptare të zhdukur prej kohësh

4 I vranë vëllain në atentat, motra e 27-vjeçarit poston foton prekëse: Jeta ime mbaroi bashkë me ty, më merr të ikim të dy

5 U ekzekutua sot në Tiranë, viktima e quante veten 'sheik', në resortin e tij grupe djemsh të armatosur reklamoheshin në rrjete sociale

Kronikë

Frika nga një atentat, Aleksandër Sadikajt iu gjet në shtëpi jelek anti-plumb dhe fishekë! Dëshmia e shokut të 27-vjeçarit: I kishte dhënë para me fajde 'Peqes' nga Kuçova

Policia ka gjetur në banesën e Aleksandër Sadikajt në Sauk një jelek antiplumb, municione dhe një kavanoz me kanabis. Duke qenë se grupi hetimor gjeti edhe një pistoletë të cilën 27-vjeçari e mbante me vete, janë ngritur dyshime te forta se i riu i druhej ndonjë atentati.

Atentati në Tiranë/ Të afërmit: Aleksandër Sadikaj, hero! S'i ka hyrë kujt në hak, djalë punëtor e i thjeshtë

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Sokol Dema
13 Qershor, 11:02 | **Përditesimi i fundit: 13 Qershor, 17:20**

Policia ka gjetur në banesën e ***Aleksandër Sadikajt*** në Sauk një jelek antiplumb, municione dhe një kavanoz me kanabis. Duke qenë se grupi hetimor gjeti edhe një pistoletë të cilën 27-vjeçari e mbante me vete, janë ngritur dyshime te forta se i riu i druhej ndonjë atentati. Për këtë po verifikohet nëse viktima është përfshirë në ndonjë konflikt gjatë kohëve te fundit.

Për policinë është ende i paqartë vendi ku është montuar lënda plasëse, ndaj po verifikohen kamerat bazuar itinerarit që ka ndjekur viktima, nga rruga "Irfan Tomini" një natë para ngjarjes, tek banesa e tij në Sauk dhe autostrada Tiranë-Elbasan, para momentit te ngjarjes. Hetuesit janë të bindur se objektiv i atentatit ka qenë Aleksandër Sadikaj edhe pse targat figuronin në emër të një tjetër personi. Viktima ka blerë automjetin pesë muaj më parë, por nuk kishte bërë ndryshimin e pronësisë së mjetit.

LEXO EDHE:
2.5 milionë euro për Sarajet e Toptanëve, Qeveria miraton fondin e shpronësimit për pronarët

Miku i fëmijërisë së Aleksandër Sadikajt ka deklaruar para hetuesve se nuk kishte dljeni në lidhje me ndonjë konflikt që Sadikaj mund të kishte me ndonjë person. Ai ka pohuar se Aleksandri mbante 2 apo 3 aparate celular, ndërsa sipas tij nuk kuptonte arsyen, me argumentin se ai nuk fliste me ndonjë person në sy të tij. Një shoku i tij nga Kuçova i njohur me pseudonimin Peqja i kishte marrë borxh atij rreth 2 milionë lekë të reja dhe do ia kthente me përqindje. Pak kohë më parë, Aleksandër Sadikaj i kishte futur ndërmjetës për të marrë lekët një tjetër person po nga Kuçova. Shuma prej 15 mije e 500 euro Aleksandrit i është dhënë disa ditë para se të ndodhte ngjarja, ndërsa kishin pasur konflikte me njëri-tjetrin për shkak të vonesës së lekëve.

Si ndodhi ngjarja?

Aleksandër Sadikaj ishte nisur drejt Memaliaj, por në aksin Sauk-TEG, makina me targa AB077PO me të cilën ai po lëvizte shpërtheu, si rrjedhojë e sasisë së tritolit. Autorët janë treguar të kujdesshëm, kjo pasi kanë vendosur që të bëjnë shpërthimin e komanduar në një moment kur nuk ka pasur në rrugë asnjë makinë tjetër përreth Sadikajt, duke shmangur rrezikun që nga ai shpërthim të vritej një person i pafajshëm. Bomba me celulare dyshohet se i është vendosur nga persona që kishin akses te makina. Nga shpërthimi Sadikaj ka humbur 2 gjymtyrët e poshtëm, këmbët, dhe ia ka dalë që të dilte vetë nga makina. Ai është ndihmuar edhe nga kalimtarët, teksa është dërguar me urgjencë në spital, por për fat të keq nuk ia ka dalë që t'i mbijetonte plagëve të marra, për rrjedhojë humbi jetën.

Kush është Aleksandër Sadikaj?

27-vjeçari ***Aleksandër Sadikaj*** është një njeri me precedent të theksuar kriminal në fushën e vjedhjes, krimeve ndaj personit dhe narkotikëve. Ai rezulton pronar i një resorti me pistë hipizmi, i njohur si "Sancho Farm Albania" në Memaliaj, vendi i origjinës së nënës. 3 vite më parë, në korrik të 2019, ishte i përfshirë në një tjetër ngjarje kriminale ku ka tentuar që të vrasë me thikë 40-vjeçarin nga Vlora Berti Tahiraj, pranë Kanalit të Cukës në Sarandë. Ndërkohë, rezultonte si autor i disa vjedhjeve apo kundërshtimeve të urdhrave të policisë. Përveç akuzave të tjera ndër vite, para 5-6 vitesh ai dyshohet se ka kryer një vrasje në Athinë për prishje pazaresh të drogës.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 17:13

Atentati në Tiranë/ Të afërmit: Aleksandër Sadikaj, hero! S'i ka hyrë kujt në hak, djalë punëtor e i thjeshtë

Nëse autoritetet policore dhe të drejtësisë e njihnin Aleksandër Sadikajn, i cili u eliminua me tritol me telekomandë, si njeri të proceduar dhe të përfshirë në ngjarje kriminale në të kaluarën, familja e kujton 27-vjeçarin si hero.

Në një postim në rrjetet sociale, familjarët e përshkruajnë Aleksandrin si djalë të vuajtur, sakrifikues dhe që nuk i ka hyrë në hak askujt. Mes rreshtave, familjarët e të ndjerit shkruajnë për fillimet e investimit në fermën në Memaliaj, për të cilën, sipas tyre Aleksandri, i ka mbjell të gjitha pemët me duartë e tij. Më tej rrëfimi vijon me një histori bamirësie që 27-vjeçari ka bërë.

sancho_farm_albania Aleksandri JONE , nje djal TRIM me plot Kuptimin e fjales nje Hero I vertete me nje zemer te madhe dhe nje shpirt femije Te cilter te bardhe, nje djal qe ka vuajtur ka sakrifikuar esht lodhur shpirterisht dhe fizikisht per familjen e tij , Alexandri qe Nuk I ka hyre ne hak askujt asnjeher ne jet , nje djal puntor I thjesht qe ka mbjell Te gjitha pemet e fermes me duart e tij Te vogla me cizme llastiku me balte dhe me tuta te shkurtra te grisura, Kemi sakrifikur familjarisht Jemi rritur me vuajtje dhe halle plot kemi emigruar dhe Te gjitha kto vuajtjet i lane Alexandrit nje shpirt te bardh te paster , Ai ishte me kembe ne toke e mbante shpin ,shpirtin dhe krahet hapur per te gjithe, ai nuk mbante inate as merri ndryshe si ne ai na mesonte te falim, Eshte gje e mir te falesh zoti thot qe duhet Te falim njerzit me ka thene , nje djal i vogel dikur I tha Alexandrit Babi im eshte ne burge Alexandri qau I mbushi syt me lot i dhembi shpirti per ate djalin vajti ne Jumbo dhe I bleu gjith ato Lodra makina, ndoshta ndoshta ju kujtua vetja tek ai femij i vetem , sepse i vetem ka liftuar ne jet Alexandri ,i vetem por Pa Lenduar njeri pa I rene meqaf njeriu cenuar jeten e askujt ai ska ber asnje gabim asnjeher me askend ata qe e njohin e dine zemren e tij te madhe dhe shpirtin e tij Te madh ,ai kishte nje dashuri te madhe per kafshet per kuajt per qenushat e mbushi shpin plot me kafshe,kujdesej ne me shpirt per kafshet edhe kur kali tij vrau kemben ai merzitej me shpirt I rinte mendja te plaga e kalit, Alexandri ka njihmuar shum njerez pa fund, ka ber miresi ,bamiresi, nje dit I thash une qe eshte nje vajze me semundje Te rende (kancer) dhe duhet te bej operacion Po ska lek Jan shum te varfer Alexandri me tha hajde vemi bashke

atje Te shpia e vajzes, ne kemi shkuar atje dhe kemi dhene leket qe ajo vajze Te ishte mir E beri Alexandri sepse I dhembi shpirti Vetem per kete gje, Ai ndihmonte pafund te gjithe shoket ,shoqet dhe miqte e tij per cdo problem qe kishin, shoket thone qe kur shikonim Alexin, sikur shikonim driten e diellit .

Postimi i fermës së në pronësi të Aleksandër Sadikaj

Ora 11:34

Atentati ndaj Aleksandër Sadikajt, shoku: I kishte dhënë para me fajde një personi me pseudonimin Peqja, patën konflikt se nuk i kthente lekët

Miku i fëmijërisë së Aleksandër Sadikajt ka deklaruar para hetuesve se nuk kishte dijeni në lidhje me ndonjë konflikt që Sadikaj mund të kishte me ndonjë person. Ai ka pohuar se Aleksandri mbante 2 apo 3 aparate celular, ndërsa sipas tij nuk kuptonte arsyen, me argumentin se ai nuk fliste me ndonjë person në sy të tij.

Po ashtu ai ka pohuar se Aleksandri nuk i kishte borxh ndonjë personi, por një shoku i tij nga Kuçova i kishte borxh atij rreth 2 milionë lekë të reja. 27-vjeçari i kishte dhënë atij një makinë dhe 5 mijë euro dhe personi nga Kuçova do ia kthente me përqindje kur të mblidhte lekët. Pak kohë më parë, Aleksandër Sadikaj i kishte futur ndërmjetës për të marë lekët një tjetër person po nga Kuçova. Shuma prej 15 mije e 500 euro Aleksandrit i është dhënë disa ditë para se të ndodhte ngjarja. Shoku i tij nga Kuçova njihej me pseudonimin Peqja, ndërsa kishin pasur konflikte me njëri-tjetrin për shkak të vonesës së lekëve.

M.Q./B.K./Shqiptarja.com

TAG: ekzekutimi i aleksander sadikaj | Tirane | aleksander sadikaj

Komento

Komente

Tirona: 13/06/2022 18:29

Po ca do te thon familjaret e shkret aman ! Ato vetem te na tregojn se ku i gjeti gjith keto lek ky te bej resort e biznese e te japi lek me fajde e te ndihmoj njerzit ne nevoj. Ku i gjeti keto lek ??????? Vetem ket te na tregojn familjaret

Përgjigju

sHQIPE: 13/06/2022 18:02

Po te afermit e lexojn kete cfar shkruan ne fillim artikulli? Po qe ta lexojn ne koment: Policia ka gjetur në banesën e Aleksandër Sadikajt në Sauk një jelek antiplumb, municione dhe një kavanoz me kanabis. Duke qenë se grupi hetimor gjeti edhe një pistoletë të cilën 27-vjeçari e mbante me vete, janë ngritur dyshime te forta se i riu i druhej ndonjë atentati

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH COM

Sondazhi i ditës:

Harta e re gjyqësore, a jeni dakord me përgjysmimin e numrit të gjykatave në vend?

PO | JO | NUK E DI

Lajme të tjera

Kronikë

Falsifikuan dokumentet dhe i morën pronën një qytetarit në Tiranë, detyrim paraqitje për 2 zyrtarë të Kadastrës, 1 te FSHZH si dhe për një ish-zyrtar

13 Qershor, 11:32

Kronikë

Shisnin kanabis në Unazën e Re dhe Yzberisht, arrestohen tre të rinj në Tiranë

13 Qershor, 08:53

Politikë

Zgjedhjet e brendshme, Veliaj: PS e vetmja forcë që mund të ndryshojë Shqipërinë! Përfundojmë Unazën e Tiranës dhe projektet

12 Qershor, 14:04

Kronikë

Ferrari i 'londinezëve' dhe Benzi me marmitë zhurmuese zgjon Tiranën, ecnin me 160 km/h! Në bypassin e Fierit 'makina inteligjente' kap shoferët më shpejtësi të frikshme (VIDEO)

12 Qershor, 13:24

Periferi

Nga politika, te këmbët e Aleksandër Sadikajt, një popull i copëtuar

Alba Malltezi

12 Qershor, 12:12

Kronikë

Bomba me celular, Aleksandër Sadikaj e mbante pistoletën në brez! Dyshohet se tritoli iu vendos në makinë nga vrasës me pagesë

12 Qershor, 10:13

Kronikë



Rrahu gruan dhe djalin e mitur, arrestohet 46-vjeçari në Tiranë! Në banesë iu gjet kokaina që e shiste në Kamëz

12 Qershor, 10:09

Kronikë

U ekzekutua në Tiranë, kush është 27-vjeçari Aleksandër Sadikaj, 1 dekadë mes krimeve! Nga Fast Food- i në pronar i një resorti në Memaliaj

11 Qershor, 21:03

Politikë

Veliaj nga Njësia 7: Na duhej një President normal, jo si Meta që rrihet me punëtorët e zyrave të bashkisë

11 Qershor, 18:07

Kronikë

Bombë me telekomandë makinës në lëvizje, vdes 27-vjeçari Aleksandër Sadikaj! Viktima pronar i një super resorti në Memaliaj! Dyshohet si autor i një vrasjeje në Athinë për drogë

11 Qershor, 14:03

Ekonomi

BE do të financojë rreth 34.7 milionë euro për Bypassin e Tiranës! Pjesë e autostradës Adriatiko-Joniane

Eliza Gjediku

10 Qershor, 19:46

Kronikë

E rëndë në Tiranë/ Fëmija 2 vjeç bie nga ballkoni i katit të pestë të pallatit, ndërron jetë

10 Qershor, 17:06

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje